



## E K S T R A K T I P R O C E S V E R B A L I T

të mbledhjes së shtatë të Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur më 15.09.2022,  
duke filluar në orën 10:00.

**Në mbledhje morën pjesë:** Fehmi Kupina, kryesues i Komitetit, anëtarët e Komitetit: Arbnora Berisha, Mirsad Vitia, Gëzim Sveçla, Nora Kelmendi, Milazim Vitija, Jeta Rafuna, Donjeta Dragusha, Leutrim Retkoceri dhe Shegë Beqiri.

**Mungoi :** Bahri Gashi.

**Në mbledhje ishin të pranishëm edhe:** Valbona Ahmeti - Makolli, drejtore e Drejtorisë së Financave, Arben Kçira, udhëheqës i Zyrës ligjore, Osman Bllaca, Adelina Sahiti, drejtore e Drejtorisë së Mirëqenies Sociale, Doruntinë Maloku, drejtore e Drejtorisë së Pronës, Besianë Musmurati, drejtore e Drejtorisë së Arsimit dhe Donika Çetta, drejtore e Drejtorisë së Parqeve.

Para së të fillonin më diskutimet për pikat e rëndit të ditës, **Valbona Makolli**, si informatë, bëri të ditur se në Vendimin për buxhetin me kërkesën e Ministrisë së Financave, e kemi shtuar edhe një klauzurë, ku lajmërohet kredia e eficiencës që është ndarë për Komunën e Prishtinës dhe Komunën Prizrenit, ky është ndryshimi.

**Besianë Musmurati** propozoi që të futet si pikë e rendit të ditës "**Propozimvendimi për transferimin e mjeteve nga kategoria e subvacioneve të administratës në kategorinë e subvacioneve të Drejtorisë së Arsimit**".

Më propozimin e dhënë, kryesuesi e hodhi në votim këtë

### R E N D TË D I TË S:

1. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së gjashtë të Komitetit për Politikë dhe Financa;
2. Raporti i punës së Kryetarit të Komunës për gjashtëmujorin e parë të vitit 2022;
3. Propozimvendimi për miratimin e buxhetit të Komunës së Prishtinës për vitin 2023 dhe kornizës afatmesme buxhetore për periudhën 2023-2025;
4. Informatë për raportin e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2021 dhe plani i zbatueshmërisë për të gjeturat e këtij rapporti;
5. Raporti i Kryetarit të Kryeqytetit për kontratat e shfrytëzimit të pronës komunale;

Faqe 1 nga 8

6. Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës së Prishtinës, me pronën e paluajtshme në pronësi të: Flora (Hasan)Çunajt, Arta(Nysret)Maliqit, Fatima(Hamit Vej Nysret) Maliqit, Arbëresha(Adem)Maliqit, Nevzat (Adem) Maliqit, Nexhat (Adem) Maliqit, Nakije (Nysret) Morinës, Nazan (Adem) Maliqit, Selamete (Hasan) Maliqit, Mevlyde (Hasan) Maliqit, Zana (Hasan) Sejdiut, Albulena (Hasan) Maliqit, Maliq (Abdul) Maliqit, Mihibe (Hasan) Makollit, Gëzim (Hasan) Maliqit dhe Luan (Nysret) Maliqit;
7. Projektrregullorja për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për organizimin dhe bashkëpunimin e Komunës me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane në territorin e komunës së Prishtinës, nr. 01-030/01-0134831/18, dt. 06.06.2018;
8. Propozimvendimi për transferimin e mjeteve nga kategoria e subvencioneve të administratës në kategorinë e subvencioneve të Drejtorisë së Arsimit.
9. Të ndryshme.

Kryesuesi konstatoi se u miratua rendi i ditës.

#### Pika e parë

Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së gjashtë të Komitetit për Politikë dhe Financa.

**Kryesuesi konstatoi se njëzëri u miratua ekstrakti i procesverbalit të mbledhjes së gjashtë të Komitetet për Polikë e Financa.**

#### Pika e dytë

Raporti i punës së Kryetarit të Komunës për gjashtëmujorin e parë të vitit 2022.

**Alban Zogaj** tha se këtë raport kryetari do ta prezantojë në mbledhje të Kuvendit. Raporti paraqet të arriturat gjatë periudhës janar - korrik 2022. Njëherësh, do të vazhdojmë me hartimin dhe projektimin edhe të 6-mujorit të dytë, i kemi të gjitha projektet edhe arritjet deri në këtë fazë.

**Gëzim Sveçla** tha se të gjitha ato që kemi për t'i thënë për këtë raport, do t'i themi në seancën e Kuvendit.

**Jeta Rafuna** u shpreh se këtu kemi pasqyrimin e aktiviteteve të Kryetarit për 6-mujorin e kaluar dhe do të raportojë për këtë.

**Leutrim Retkoceri** theksoi se kjo është në rregull, vetëm e përshëndesim.

**Kryesuesi konstatoi se u miratua Raporti i punës së Kryetarit të Komunës për gjashtëmujorin e parë të vitit 2022 dhe dërgohet në Kuvend për diskutim.**

#### Pika e tretë

Propozimvendimi për miratimin e buxhetit të Komunës së Prishtinës për vitin 2023 dhe kornizës afatmesme buxhetore për periudhën 2023-2025

**Valbona Ahmeti - Makolli** informoi se kanë qenë 6 dëgjime publike buxhetore, një ka qenë për Kornizën afatmesme buxhetore dhe 5 të tjera kanë qenë dëgjime, ku kemi pasur kërkesa, dhe ato që kemi pasur mundësi i kemi përfshirë, projektet i kemi pa, i kemi diskutuar. Buxheti për kryeqytetin është 105,675,981€.

Po ashtu, informoi se në dakordim me Ministrin e Financave, te Korniza buxhetore afatmesme e kemi lënë një informatë shtesë, nëse ka gjatë dëgjimeve buxhetore ose buxheti ndonjë ndryshim, atëherë do të inkuadrohen. Kjo është bërë në bazë të buxhetit ku ka pasur ndryshime.

**Gëzim Sveçla** parashtroi pyetje se pse të dyja bashkë, KAB dhe Buxheti janë paraqitur si një pikë e rendit të ditës. A kanë për t'u votuar si dy dokumente, ku p.sh. ne mundemi me qenë dakord për njëren, ndërsa për tjetren jo, andaj kërkoj që të ndahen këto dy dokumente të ndryshme, se njëra është periudhë 1-vjeçare, ndërsa tjetra 3-vjeçare. Po ashtu, pyeti se a mundemi gjatë seancës me ndryshuar diçka në buxhet, me shtuar projekte, si është e rregulluar kjo çështje?

**Valbona Ahmeti - Makolli** tha se mundemi me e ndarë në dy pika, mirëpo KAB nuk votohet se ai veç është votuar, vetëm ka ndryshime që janë bërë për vitin 2023, projekte të reja. Sa i përket pyetjes se a mundemi me ndryshuar, me futur ndonjë projekt gjatë seancës, unë nuk besoj, sepse dëgjimet buxhetore kanë qenë ato që e kanë dhënë vulën për këtë buxhet, megjithatë është kompetencë e kryetarit.

**Gëzim Sveçla** u shpreh se pasi që vetëm buxhetin kemi me votuar, atëherë vetëm titullin e pikës së rendit të ditës me ndryshuar, se po i bie se po i votojmë të dy pikat.

**Jeta Rafuna** theksoi se është fjala për një buxhet të planifikuar mirë, ku janë përfshirë edhe premtimet e kryetarit dhe kërkesat e qytetarëve nëpër dëgjime buxhetore, andaj edhe e përkrahim këtë dokument.

**Leutrim Retkoceri** shprehu mendimin se buxheti është i përgatitur mirë, ku shpërndarjen e ka të organizuar mirë dhe ka rritje të numrit të projekteve, që është pozitive.

Ai ngriti dy çështje: një që duhet të ketë kod buxhetor, është edhe fillimi i procedurave për ndërtimin e shtatores së heroit Adem Jashari, në Prishtinë, dhe çështja tjetër është çështja e "Hortikulturës", që vlera e caktuar është e ulët po thuaj 30%, dhe kjo mund të ndodhë me i rrezikuar punëtorët e kësaj ndërmarrje, sepse buxheti i vitit të kaluar ka qenë i planifikuar 1.6 milion €, e kësaj here iu kanë ndarë 1 milion €, kështu që mbetet me u parë a do t'i mbulojë shpenzimet dhe pagat e punëtorëve në këtë ndërmarrje. Nëse jo, të shikohet me ndryshim apo ndonjë mënyrë të subvencionimit që të mbështetet kjo pjesë.

**Valbona Ahmeti - Makolli** dha sqarime lidhur me këto dy çështje të parashtruara nga Leutrimi.

Kryesuesi konstatoi se u miratua Propozimvendimi për buxhetin e Komunës së Prishtinës për vitin 2023 dhe korniza afatmesme buxhetore për periudhën 2023-2025, dhe dërgohet në Kuvend për miratim.

### Pika e katërt

Informatë për reportin e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2021 dhe plani i zbatueshmërisë për të gjeturat e këtij reporti.

Faqe3nga8

**Osman Bllaca** dha sqarime, duke thënë se raporti i Zyrës Kombëtare të Auditimit nuk mund të ndryshohet. Çfarëdo ndryshimi, sugjerimi apo kërkesë që vjen prej anëtarëve është i pandryshueshëm. Ky është një raport që bëhet prej një organizate tjeter, jo prej Komunës, por pasi që jam auditor i brendshëm dhe kërkesa e kryetarit ka qenë me marrë parasysh çka do që diskutohet lidhur me reportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit, ndërsa e keni edhe Planin e veprimit, që është rizbatim i rekomandimeve, e aty mundeni nëse ka ndonjë kërkesë me bërë, se ai është dokument i Komunës, aty mundemi me bërë.

**Gëzim Sveçla** tha se vërejtjet dhe sugjerimet do t'i paraqesim në seancën e Kuvendit.

**Donjeta Dragusha** u shpreh se reportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit e kam analizuar dhe mendoj se është shqetësuese që Zyra Kombëtare e Auditimit për vitin 2021, jep opinion të kualifikuar, që do të thotë se ka pasur keqdeklarime në pasqyrat financiare dhe mos pajtueshmëri me rregulloret dhe ligjet për zbatimin dhe shpenzimin e parasë publike.

Po ashtu, është shqetësues fakti që Qeveria e kaluar nuk është marrë vazhdimisht me zbatimin e rekomandimeve të Zyrës Kombëtare të Auditimit, me vetë faktin që 9 rekomandime prej vitit 2020 nuk janë adresuar fare për zbatim dhe çdoherë janë përsëritur në vitin 2021.

Ajo çka është pozitive këtë vit, është se kryetari me ekzekutivin kishin përgatitur një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve të detajuar, duke i adresuar edhe personat përgjegjës për zbatimin e secilit rekomandim dhe ishte paraparë të zbatohen brenda vitit 2022. Shpresojmë se do të zbatohen këto rekomandime, sepse kishte vërejtje serioze në këtë raport.

**Osman Bllaca** dha sqarime lidhur me rekomandimet.

**Leutrim Retkoceri** tha se opinioni veç qenka i deklaruar, çka mbetet me u pa është se a është bërë plani për zgjidhje të adresimit.

**Osman Bllaca** u përgjigj se është bërë plani për zgjidhje të adresimit, ua kam dërguar.

**Leutrim Retkoceri** tha se e kam një ide, që me një të gjetur me pa se a është përfshirë në plan për me u përmirësuar për këtë vit, kështu që mendoj se si raport është, ka hapa që janë përmirësuar, ky është i vitit 2021.

**Valbona Ahmeti - Makolli** dha sqarime lidhur me rekomandimet dhe të gjeturat.

**Kryesuesi konstatoi se u miratua Informata për reportin e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2021 dhe plani i zbatueshmërisë për të gjeturat e këtij rapporti, dhe dërgohet në Kuvend për diskutim.**

**Pika e pestë**

**Raporti i Kryetarit të Kryeqytetit për kontratat e shfrytëzimit të pronës komunale.**

**Doruntinë Maloku** tha se është hera e parë që Kryetari i Kryeqytetit i raporton Kuvendit të Komunës për shfrytëzimin e pronës komunale dhe kontratave valide që ka Komuna në raport me palët dhe për detyrimet që kanë palët. Në raport është paraqitur edhe gjendja jo vetëm e kontratave valide, por e gjendjes që e kemi identikuara edhe në Zonën industriale, po ashtu edhe shfrytëzimin e banesave të Komunës së Prishtinës në lagjet "Bregu i Diellit", Hajvali dhe "Fusha e Pajtimit". Gjithashtu, edhe reportin e kontratave valide apo marrëveshjeve që Komuna ka me Qeverinë e Republikës së Kosovës për shfrytëzimin e pronës komunale.

**Nora Kelmendi**, sa i përket raportit, tha se ne keni dërguar vetëm 2-3 exella, nuk mund të quhet raport se janë vetëm disa tabela, ku kemi vetëm numra, që tregojnë kontratat se deri në cilin vit janë në shfrytëzim pronat, nuk ka raportim me shkrim, por shpresoj për seancë të na sillet një raport i mirëfilltë me shkrim.

**Jeta Rafuna** u shpreh se është hera e parë që i kemi tabelat -excell. Në mandatet tjera i kemi kërkuar, por nuk na i kanë sjellë dhe nuk kanë reportuar asnjëherë.

**Leutrim Retkoceri** theksoi se kjo pikë po lidhet me pikën paraprake të raportit të auditimit, që i ka të gjetura, por ka qenë shumë e nevojshme me u informuar edhe Kuvendi dhe opinioni me çështjen e pronave dhe nëse kanë apo nuk kanë kontratë. Sa i përket raportit, mbetet me u pa në seancë kur lexohet nga kryetari.

**Doruntinë Maloku** dha sqarime shtesë.

**Kryesuesi konstatoi se u miratua Raporti i Kryetarit të Kryeqytetit për kontratat e shfrytëzimit të pronës komunale dhe dërgohet në Kuvend për diskutim.**

#### Pika e gjashtë

Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës së Prishtinës, me pronën e paluajtshme në pronësi të: Flora (Hasan) Çunajt, Arta (Nysret) Maliqit, Fatima (Hamil Vej Nysret) Maliqit, Arbëresha (Adem) Maliqit, Nevzat (Adem) Maliqit, Nexhat (Adem) Maliqit, Nakije (Nysret) Morinës, Nazan (Adem) Maliqit, Selamete (Hasan) Maliqit, Mevlyde (Hasan) Maliqit, Zana (Hasan) Sejdiut, Albulena (Hasan) Maliqit, Maliq (Abdul) Maliqit, Mihibe (Hasan) Makollit, Gëzim (Hasan) Maliqit dhe Luan (Nysret) Maliqit.

**Doruntinë Maloku** tha se ky është një propozivendim për këmbimin e pronës së paluajtshme, që ka ardhur si propozim prej Drejtorisë së Urbanizmit. Drejtoria e Pronës i ka zhvilluar procedurat e nevojshme sipas Planit rregullues.

**Gëzim Sveçla** bëri të ditur se ka informacione se po anashkalohen qytetarët në këtë listën e pristes për këmbimin e pronave, andaj kërkoj të di se a mundemi me pasur qasje në atë listë. **Doruntinë Maloku** bëri të ditur se nuk ekziston një listë e tillë. Lëndët që i kam pasur në procedurë, d.m.th. kur e kam marrë në udhëheqje drejtorinë, të gjitha lëndët që kanë qenë në procedurë kryesisht i kemi procedurë, përveç lëndët që nuk kanë qenë në rregull.

**Gëzim Sveçla** pyeti se a mundemi me marrë listën.

**Doruntinë Maloku** tha mundeni, por paraqiteni një kërkesë për qasje të dokumenteve.

**Kryesuesi konstatoi se u miratua Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës së Prishtinës, me pronën e paluajtshme në pronësitë të: Flora (Hasan) Çunajt, Arta (Nysret) Maliqit, Fatima (Hamil Vej Nysret) Maliqit, Arbëresha (Adem) Maliqit, Nevzat (Adem) Maliqit, Nexhat (Adem) Maliqit, Nakije (Nysret) Morinës, Nazan (Adem) Maliqit,**

**Selamete (Hasan) Maliqit, Mevlyde (Hasan) Maliqit, Zana (Hasan) Sejdiut, Albulena (Hasan) Maliqit, Maliq (Abdul) Maliqit, Mihibe (Hasan) Makollit, Gëzim (Hasan) Maliqit dhe Luan (Nysret) Maliqit, dhe dërgohen në Kuvend për miratim.**

#### **Pika e shtatë**

Projektrregullorja për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për organizimin dhe bashkëpunimin e komunës me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane në territorin e komunës së Prishtinës, nr. 01-030/01-0134831/18, dt. 06.06.2018.

**Osman Bllaca** dha sqarime, duke cekur se është krijuar një komision, janë bërë ndryshime të Udhëzimit administrativ që është bërë përfshira fshatra dhe vendbanime, andaj është dashur të ndryshohet Rregullorja. Janë marrë parasysh diskutimet publike që janë mbajtur me qytetarë, kryetarë të BL-ve, komisionit që ka punuar dhe janë bërë ndryshimet. Pra, është një propozim për ndryshimin dhe plotësimin e kësaj rregulloreje. Nëse keni diçka për të shtuar apo inkorporuar ka kohë dhe hapësirë, kështu që i harmonizojmë deri për seancën e Kuvendit.

**Jeta Rafuna** parashtroi pyetje se kur do të formohet komisioni për organizimin e zgjedhjeve të kryetarëve të BL -ve.

**Osman Bllaca** dha sqarime.

**Milazim Vitija** shprehu mendimin se do të duhej që secili drejtor që ka në rend dite ndonjë pikë, të jetë i pranishëm në mbledhje, sepse sot ne e kemi raportin për vitin 2023 e shumica e drejtorëve nuk janë këtu.

Rregullorja ka shkuar në diskutim publik dhe është kthyer, unë i kam 2-3 vërejtje. P.sh. te BL-Mramor, ku ne kuadër të Mramorit nuk është vetëm Busia dhe Novo-Sella, por është edhe Suteska dhe Zllashi.

**Osman Bllaca** tha se nuk mundemi me bërë ndryshime të BL -të, përfshakat sistemit të adresave, me Mramor përfshihet edhe Butovci.

**Milazim Vitija** tha se Butovci po kërkojnë të bashkëngjitën me Prishtinë, e Zllashi me Mramor sepse kanë qenë çdo herë.

Në kuadër të BL-së Slivovë është Kukavica, Dragovci, por do të duhej të ishte edhe Llajshevci dhe Mukati. Kur është fjala te kilometratë katrorë, fshati Marec është  $112 \text{ km}^2$ , e këtu është dhënë  $78 \text{ km}^2$ . Kishte qenë mirë që këto vërejtje me u marrë parasysh përfshikuar seancë e radhës së Kuvendit.

**Alban Zogaj** kërkoi nga parafolësi që të gjitha vërejtjet t'i përcjellë me shkrim dhe ia dërgojmë drejtorit.

**Kryesuesi konstatoi se u miratua Projektrregullorja për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për organizimin dhe bashkëpunimin e komunës me fshatrat, vendbanimet dhe**

lagjet urbane në territorin e komunës së Prishtinës, nr. 01-030/01-0134831/18, dt. 06.06.2018, dhe dërgohet në Kuvend për miratim.

#### Pika e tetë

**Propozimvendimi për transferimin e mjeteve nga kategoria e subvencioneve të administratës në kategorinë e subvencioneve të Drejtorisë së Arsimit.**

**Leutrim Retkoceri** kërkoi sqarime shtesë lidhur me këtë propozimvendim.

**Besianë Musmurati** dha sqarime shtesë, duke cekur se do të formojnë një komision brenda Komunës, që të shkojë t'i vërtetojë të gjitha të dhënat të cilat janë dërguar prej çerdheve me bazë me komunitet. Si model ka rezultuar shumë i suksesshëm dhe besoj se është bërë një punë e mirë, mirëpo na duhet pak më shumë kontroll prej anës së DKA-së, e në anën tjetër me parë se qysh mundemi me përmirësuar pak si model, për me qenë më i qëndrueshëm financiarisht, për shkak se e kemi parë analizën që përgjatë viteve subvencionet e Komunës kanë shkuar duke u shtuar. Në fakt modeli ka qenë me shkuar duke u zvogëluar dhe baza financiare për Komunën duke u zvogëluar, por një gjë e tillë nuk ka ndodhur, andaj duhet me shikuar se çfarë modeli duhet gjetur, që çerdhet me bazë me komunitet me vazhduar funksionimin si model i mirë dhe me i plotësuar me disa çështje.

**Gëzim Sveçla** tha se te pika 3 e këtij vendimi, thotë "...për realizimin e pagesave të dy çerdheve", a po flasim për paga a për çka është fjalë?

**Besianë Musmurati** sqaroi se dy çerdhe janë për paga për muajin korrik, "Botanika" dhe "Cicërimat" dhe prej gushtit janë të gjitha çerdhet bashkë.

**Gëzim Sveçla** tha se ne duhet me i ndarë këto mjete, që janë 120 mijë €, a nuk ka qenë në rregull planifikimi a çka është në pyetje?! Po thoni është projekt i suksesshëm, e në anën tjetër ne vazhdimisht po duhet me subvencionuar!

**Besianë Musmurati** dha sqarime lidhur me çështjet e parashtruara nga z. Sveçla.

**Gëzim Sveçla** tha se me këtë qëndrueshmërinë financiare duhet me u marrë më shumë.

**Alban Zogaj** theksoi se modeli finansiar është i paqëndrueshëm.

**Besianë Musmurati** shprehu mendimin se ndoshta një mënyrë e mirë është edhe shtimi i numrit të fëmijëve që janë 100% me pagesë, që edhe ata me shkuar me e mbuluar këtë pjesën e subvencioneve.

**Osman Bllaca** sqaroi, duke thënë se nuk mundesh pasi që janë kriteret për pranim të fëmijëve, pasi të pranohen ata fëmijë atëherë janë kriteret për lirim nga pagesa.

**Besianë Musmurati** theksoi se duhet shikuar edhe kriteret se çka duhet me bërë.

E kam dërguar stafin me shkuar, problemi është se nuk është një dokument që ju thotë atyre keni me e sjellë trustin, xhirollogarinë bankare etj., pastaj me marrë një vendim bazuar në fakte.

**Kryesuesi konstatoi se u miratua Propozimvendimi për transferimin e mjeteve nga kategoria e subvencioneve të administratës në kategorinë e subvencioneve të Drejtorisë së Arsimit dhe dërgohet në Kuvend për miratim.**

### **Të ndryshme**

**Milazim Vitija** e inicioi çështjen e ndërmarrjes "Prishtina Parking", e cila është ndërmarrje komunale. Ai tha se kishte qenë mirë me u liruar nga pagesa për parking asamblistët, familjet e dëshmorëve dhe veteranët. Mendoj se "Prishtina Parking" do të duhej t'i liron te këto kategori, pasi që në shumicën e vendeve këto kategori janë të liruara.

**Alban Zogaj** tha se do të ketë diskutim publik për rregulloren e re, e në rregulloren e re parashihen disa lirime, siç po i përmendeni ju, aty duhet me i propozuar, aty këtë ide me diskutuar, është duke u punuar, së shpejti do të dalë në diskutim publik.

**Milazim Vitija** pyeti a do të sillet në Kuvend.

**Alban Zogaj** tha se do të sillet edhe në Kuvend. Në diskutim publik do të jetë një muaj, aty ke rastin me i dhënë këto komente, për ndryshe është diskutuar që asamblistët me i liruar nga pagesa.

**Leutrim Retkoceri** tha se kur kemi të bëjmë me çështjen e ndryshimeve të Rregullores dhe çështjen e buxhetit, mendoj se është e nevojshme me pasur një takim para se me ardhur në KPF dhe para se me ardhur në seancë të Kuvendit, para votimit të ketë trajtimin e njëjtë sikurse dëgimi publike me qytetarë, por të ketë seancë ku diskutohet me asamblistët dhe të vjen një e-mail ku do të kemi rastin që kësi propozime ta adresojmë aty.

Poashtu, shprehi shqetësim për librat e klasës së pestë që nuk kanë arritur, pse është kjo vonesë.

**Besianë Musmurati** të gjitha librat e klasave janë furnizuar nga Ministria e Arsimit nëpër shkolla, vetëm librat e klasës së pestë nuk kanë ardhur, nuk e di pse nuk i ka sjell Ministria, por nuk i kemi.

**Leutrim Retkoceri** pyeti se a është përgjegjësi e Komunës.

**Besianë Musmurati** u përgjigj se është përgjegjësi e Ministrisë, asnjë komunë nuk e ka furnizuar. Ka mundësi të jetë ndonjë telashe me prodhuesin apo prokurimin.

**Leutrim Retkoceri** tha se nëse jeni në komunikim me iu shkruar zyrtarisht. Po shpresojmë se nëse fillon procesi mësimor, atëherë krejt klasat e pesta janë pa material!

**Besianë Musmurati** tha librat kemi nisur me i shpërndarë, edhe pse janë në greva janë duke i shpërndarë librat në të gjitha shkollat e Prishtinës.

*Mbledhja përfundoi në orën 11:15.*

Procesmbajtësja  
Shyhrete Islami

Kryesuesi i Komitetit  
Fehmi Kupina

Faqe8nga8

